



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

RELACION
MBI VLERËSIMET E ERE PËR KOSTOT E AKTIVITETIT TË FURNIZUEIST TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1.05.2022 – 31.12.2022

Të Nderuar anëtarë të Bordit,

Në mbështetje të nenit 83 dhe nenit 85 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit.

Bordit ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017 ka miratuar “Metodologjinë e Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 21, të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës, jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Aplikimet e paraqitura nga operatorët e licencuar nga ERE, duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të nenit 22 të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s dhe “Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 244, datë 26.11.2018.

Lidhur me çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2022.

Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim për miratimin e çmimeve me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal, bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

Bordi i ERE-s me Vendimet nr. 233 dhe nr. 234, datë 19.11.2021 ka vendosur mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes për vitin 2022 dhe shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.

ERE me anë të shkresës nr. 925/4 Prot. datë 16.11.2021, ka njoftuar shoqërinë FSHU sh.a. mbi aplikimet për tarifa të rrjetit nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes dhe ka kërkuar prej saj të përcjellë një set të dhënash dhe informacionesh, ku përfshihen ndër të tjera: i) pritshmëria e shoqërisë FSHU sh.a. mbi transferimin e kostove të rrjetit të kërkuara nga operatorët, kostot e blerjes së energjisë dhe kostot e tjera të aktivitetit të shoqërisë për çdo kategori klientësh që do të furnizohen nga FSHU gjatë vitit 2022 dhe ii) struktura e çmimeve që pritet të aplikohet nga shoqëria për të përfituar të ardhurat e nevojshme për mbulimin e kostove të aktivitetit ushtrimor të parashikuara për vitin 2022.

Shoqëria FSHU sh.a, me shkresën nr. 10420 Prot, datë 06.12.2021, në përgjigje të shkresës nr. 925/4 Prot. datë 16.11.2021, ndër të tjera ka theksuar se FSHU është në pritje të vendimeve të ERE për tarifën dhe çmimet lidhur me transferimin e kostove të rrjetit për klientët tariforë dhe mbështetur në vendimet dhe deklaratat e Qeverisë së Shqipërisë, FSHU pret mosndryshim të çmimeve të shitjes së energjisë për klientët në nivelin e tensionit 0.4 kV.

Në mënyrë që shoqëria FSHU sh.a edhe për vitin 2022, të mundej të realizonte aktivitetin për të cilin është licencuar, konform Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe që të vijonte faturimin bazuar në çmimet e miratuara nga ERE, Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021 vendosi ndër të tjera:

Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 214, datë 15.12.2020, deri në vlerësimin e ERE-s për transferimin e kostove të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike të çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

si dhe

Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërive, do të bëhet korigjimi dhe kompensimi përkatës i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 20, gërma “c”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe metodologjive përkatëse, të miratuara nga ERE.

Për sa më sipër si dhe në vijim të dispozitave të vendimit sipërcituar, u krye një vlerësim lidhur me efektet e transferimit të kostove të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike tek çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në mungesë të aplikimit të shoqërisë dhe një parashikimi të kostove të cilat pret të realizojë FSHU sh.a. për vitin 2022, kemi kryer vlerësimet paraprake mbi aktivitetin e shoqërisë, mbështetur në të dhënat e përcjella me anë të shkresës sipërcituara për realizimin e 10 mujorit të vitit 2021, si dhe të vlersimeve të kryera nga ERE për çdo vit të periudhës 2015-2020 bazuar në raportimet e shoqërisë, në të cilat janë mbështetur dhe vendimarrjet respektive.

Ecuria e aktivitetit të shërbimit të furnizimit universal i cili tashmë ushtrohet që prej vitit 2020 nga FSHU sh.a. ka patur një trend të ekuilibruar. Në vitet 2015 dhe 2016, shoqëria ka rezultuar me fitime të cilat kanë shërbyer për të përballuar koston e humbjeve mbi target të realizuar nga aktiviteti i shpërndarjes së energjisë elektrike. Sa i takon vitit 2020 konstatohet se shoqëria ka

rezultuar me fitim, i cili ka ardhur për arsye të kostosve të ulta të blerjes së energjisë si dhe uljes së konsumit vëndas për shkak të pandemisë covid 2019.

Për të patur një evidencë të vijimësisë së shpenzimeve operative për secilën periudhë dhe për të vlerësuar mbi parashikimet e tyre për vitin 2021 dhe vitit 2022, ishte e nevojshme shpërndarja e vlerës së shpenzimeve operative të vitit 2020 sipas kategorive të njohura nga ERE dhe të pranuar nga FSHU sh.a. sikurse paraqitur dhe në aplikimet e periudhave të mëparshme.

Në mungesë të aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a., edhe pasi është bërë me dije mbi vendimin e ERE mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të shoqërive OST dhe OSSH si dhe propozimit të tyre, mbështetur në të dhënat në dispozicion nëpërmjet procesve të mbyllura tarifore si dhe pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2020, është vijuar me kryerjen e një analize dhe vlersimi për llogaritjen e kostove të pritshme për vitin 2021 si dhe parashikimin e kostove të aktivitetit të furnizimit universal për vitin 2022.

Për zëra të identifikueshëm në pasqyrat financiare, janë konsideruar vlerat e paraqitura nëpërmjet shkresës së sipërcituar, ndërsa për zërat për të cilët nuk kemi patur informacion por dhe pasiguri në vlerën e realizuar të shpenzimeve operative prej FSHU sh.a., kemi konsideruar vlerat e pranuar dhe njohura nga ERE në kuadër të vlersimeve të kryera në periudhat e mbyllura ushtrimore.

Qëllimi i këtij vlersimi është përlllogaritja e kostove të aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal pas transferimit të kostove të aktivitetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe kostove të blerjes së energjisë.

Në vijim paraqesim përlllogaritjet e kostove të aktivitetit të furnizimit univesal

Zeri	2015 miratuar nga ERE	Vlersimi i ERE							
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	Parashikim 2021	Parashikim 2022
Shpenzime materiale dhe konsumi	64	90	64	69	35	36	37	20	21
Shpenzime për personelin	899	699	1,038	1,037	1,004	962	730	798	822
Mirembajtje Shërbime nga palët e treta	279		282		0	0	269	277	285
Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing	13		16	5	2	3	3	3	3
Qera	62	118	86	95	173	189	125	129	132
Sherbime Postare dhe Komunikimi	400	47	135	733	707	728	750	772	795
Shpenzime Teknologjia e informacionit	6		30	3	10	33	34	35	36.1
Shpenzime Ligjore	39		15	11	17	12	12	12	12.7
Konsulence dhe Auditim	68		33	12	20	26	27	33	34
Te tjera	238	53	214	252	230	294	303	312	321
Total OPEX	2,068	1,007	1,913	2,217	2,198	2,282	2,358	2,391	2,463
Kosto e blerjes së energjisë									
Tarifa e blerjes se energjise nga FPSH Lek/KWH	3.00	3.00	3.00						
Blerjet e energjise nga FPSH- GWH	4,544	4,459	2,284						
Kosto totale e blerjes se energjise nga FPSH - Lek 000s	13,632	13,378	6,852						
KESH			2,029	2,884.00	3,875.56	2,878.44	2,974.46	3,931.63	4,612.98
cmimi			1.45	1.45	1.50	1.50	1.50	1.50	2.60
kosto e blerjes se energjise nga kesh			2,942	4,182	5,813	4,318	4,462	5,897	11,994
Ashta			114						
cmimi			8.06						
kosto e blerjes se energjise nga Ashta			919						
Prodhuesit me përparësi			178						
cmimi i blerjes			7.448						
Kosto e blerjes se energjise nga prodhuesit me përparësi			1,326						
Tregu i lirë				1,898	952	2,136	2,048	1,516	
cmimi i blerjes				8.94	9.41	9.23	6.69	20.11	
kosto e blerjes se energjise nga tregu				16,968	8,954	19,721	13,704	30,483	
Marzhi i fitimit	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%	2.20%
Fitimi	300	294	265	465	325	529	400	800	264
Kosto e transmetimit te energjise	2,954	2,899	2,993	3,108	3,620	3,760	3,764	4,086	3,921.03
Kosto e shperndarjes se energjise	21,757	21,361	22,059	22,906	23,122	24,014	24,040	26,093	29,615.33
AMORTIZIMI							29	44	50
Kosto e disbalancave		0	92	642	471	646	286	295	303
Kapitali i Punës									3,999
Kostoja e financimit të kapitalit të punës									3.00%
Vlera e financimit te kapitalit të punës									120
Shpenzime Borxhi te Keq	2,315	1,947	1,968	2,524	2,225	2,763	2,452	3,504	2,436
Marreveshje qeveritare	3,433	3,051	2,895	2,788	2,819				
Korigjim i të ardhurave									(2,529)
Te Ardhurat e Kerkuara Totale te FPP	-	43,937	44,224	55,801	49,548	58,033	51,494	73,594	48,638
Shitjet e energjise	4,544	4,459	4,605	4,782	4,827	5,013	5,019	5,447	4,613
Cmimi mesatar per konsumatoret tarifore	10.70	9.85	9.60	11.67	10.26	11.58	10.26	13.51	10.54

Përtej këtyre të ardhurave të korigjueshme, shoqëria do të faturojë dhe kostot administrative të cilat priten të rikuperohen nëpërmjet aktivitetit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

Rikuperimi i kostove administrative, të cilat priten të faturohen dhe arkëtohen nga FSHU në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, korigjohen në zbritje të të ardhurave të kërkuara të aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal, përlllogaritjen e të cilave e paraqesim në vijim:

Përshkrimi	FMF
Sasia 35/20/10/6 kv	1,083
Kosto administrative	1.06
Vlera	1,148

Korrigjimi i të ardhurave të kërkuara në tërësi për periudhën 2015-2021 evidentohet si vijon:

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Parashikim 2021	Parashikim 2022
Cmimi mesatar ne fuqi	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	
Diference ne rritje/zbritje	(0.85)	(1.10)	0.97	(0.44)	0.88	(0.44)	2.81	
vlera per tu korigjuar	- 3,779	- 5,052	4,633	- 2,102	4,390	- 2,207	15,306	
						Total		11,190
cmimi mesatar i realizuar	11.22	11.19	11.12	11.15	11.03	10.87	10.94	
Sasia	4459	4605	4782	4827	5013	5019	5443	
Diference ne rritje/zbritje	(0.52)	(0.49)	(0.42)	(0.45)	(0.33)	(0.17)	(0.24)	
Vlere per tu korigjuar	- 2,319	- 2,257	2,008	- 2,172	1,654	- 853	- 1,307	
						Total		- 12,571
						Diference në të ardhurat e kërkuara		- 1,381
VLERË TOTALE PER TU KORIGJUAR	(6,097.49)	(7,308.67)	2,624.99	(4,274.07)	2,735.43	(3,059.91)	13,998.70	- 1,381
Të ardhura që priten të meren nga aplikimi i kostos administrative te cmimi i konsumatorëve që furnizohen në kushtet e FMF								- 1,148
						TOTAL		- 2,529

Qeveria Shqiptare me anë të VKM nr. 758/2021, ka rishikuar targetet e humbjeve të OSSH për periudhën 2014-2026, si dhe nivelin e arkëtimeve të shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2022 sipas tabelës ne vijim:

	Humbjet totale (%)	Mbledhja e të ardhurave (%)
2014	37.8	91.9
2015	31.3	98.3
2016	28.0	92.0
2017	26.4	97.0
2018	23.9	95.0
2019	21.8	95.0
2020	21.5	95.0
2021	20.5	95.0
2022	19.6	95.0
2023	19.0	
2024	18.5	
2025	18.1	
2026	17.8	

Bordi I ERE me vendimin nr.190/2018, është shprehur se:

Nga raportimi i strukturës së shitjes për vitet 2015 -2017 rezulton që çmimi mesatar i realizuar nga shitja është më i larte nga ai miratuar prej 10.7 lekë/kWh, duke rezultuar me të ardhura shtesë për shoqërinë. Këto diference vlerësohen të përdoren si rezervë për mbulimin e kapitalit negativ të trashëguar që nga viti 2014, duke i mundësuar shoqërisë aftësinë për likuidimin e detyrimeve si dhe mbulimin e kostove të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi target.

Për sa më sipër, janë kryer përllogaritjet e kostos së humbjeve dhe kostos së transmetimit të humbjeve të realizuara mbi targetin e vendosur në vitin 2015 sipas parashikimeve të VKM sipërcituar, krahas kostove të njohura nga ERE për llogaritjen e tarifës mesatare të shpërndarjes për vitin 2015, e cila është lënë në fuqi sipas vendimmarrjeve respektive të ERE si vijon:

Kosto e blerjes së humbjeve	2015	2016	2017	2018	2019
<i>Kosto e transmetimit për humbjet</i>	1,323,024	1,166,393	809,097	714,872	610,800
<i>Kosto e transmetimit për humbjet e njohur nga ERE në vitin 2015</i>	787,028	787,028	787,028	787,028	787,028
<i>Kosto e transmetimit për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>	535,996	379,365	22,069	- 72,157	- 176,228
Kosto e humbjeve Totale	13,035,106	11,294,370	13,873,056	13,010,886	12,730,956
<i>Kosto e humbjet e njohur nga ERE në vitin 2015</i>	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257	9,323,257
<i>Kosto e për humbjet mbi target sipas VKM 253</i>	3,711,849	1,971,113	4,549,799	3,687,630	3,407,699
				Total 2015-2019	18,017,136
Të ardhura të korigjueshme nga aktiviteti i furnizimit universal që kanë shërbyer për mbulimin e humbjeve mbi target	2015	2016	2017	2018	2019
	- 6,097,494.41	- 7,308,667.01	2,624,994.53	- 4,274,065.21	2,735,429.45
				Total 2015-2019	- 12,319,803

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme, për periudhën 2015-2019, kohë në të cilën aktiviteti i shpërndarjes së energjisë elektrike dhe i furnizimit të shërbimit universal ushtroheshin nga Shoqëria OSHEE sh.a., kosto e blerjes së humbjeve mbi target dhe kosto e transmetimit të tyre është realizuar në vlerën 18 miliard lekë, ndërkohë që të ardhurat e korigjueshme të cilat kanë shërbyer për mbulimin e humbjeve mbi target janë realizuar nga aktiviteti i shërbimit universal në vlerën 12.3 miliard lekë.

Sasia e parashikuar për tu shitur nga shoqëria FSHU sh. për klientët fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, është 4,613 GWh.

Pas përllogaritjes së kostove të parashikuara të aktivitetit të shoqërisë për vitin 2022, është kryer segmentimi i tyre sipas tipologjisë për të evidentuar dhe ndarë komponentët përbërës të çmimit mesatar të shitjes së energjisë elektrike si dhe peshës që zë secili komponent në kostot e aktivitetit të FSHU sh.a..

Në vijim paraqesim segmentimin e kostove të aktivitetit të furnizimit universal për vitin 2022:

Kosto administrative

Përshkrimi	Vlersimi i ERE 2022
OPEX	2,463
BORXHI I KEQ	2,436
Total	4,899
Sasia e enegjise se shitur	4,613
Kosto administrative dhe shpenzime te tjera (CA)	1.06

Kosto administrative e përllogaritur për FSHU sh.a. për vitin 2022 ka rezultuar 1.06 lekë/kWh dhe për rrjedhojë, kjo kosto do të jetë kosto përfaqësuese e shoqërisë për periudhën 1 Maj-31 Dhjetor 2022, meqënëse dhe tarifat e reja të përllogaritura prej ERE do të hynë në fuqi për periudhën sipërcituar duke konsideruar dhe të ardhurat e munguara për periudhën 1 Janar - 30 Prill, sipas arsyetimeve të relacioneve përkatëse të përllogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit dhe tarifave të shpërndarjes për nivele tensioni.

Kosto e blerjes së energjisë

Kosto e blerjes se energjise	11,994
Sasia e enegjise se shitur	4,613
Kosto e blerjes blerjes	2.60

Sa i takon koston së blerjes së energjisë, kemi konsideruar të dhënat e përcjella nga FSHU sh.a. me shkresën nr.1395/2, datë 31.03.2022 në të cilën evidentohet se Asamblesë së Përgjithshme të KESH me Vendimin Nr. 1349/1, datë 16.02.2022 "Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2022 prashikimin 2023-2026" ka vendosur ndër të tjera se çmimi për njësi për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal do të jetë 2.6 lekë/kWh.

Amortizimi dhe kosto e disbalancave

Amortizimi	50
Sasia e energjise per tu shitur	4,613
Kosto e amortizimit	0.01
Kosto e disbalancave	303
Sasia e energjise per tu shitur	4,613
Kosto e disbalancave	0.07

Amortizimi i konsideruar është ai i paraqitur nga FSHU sh.a. për periudhën 10 mujore 2021, i cili është mesatarizuar për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve vjetore.

Kosto e disbalancave e konsideruar është ajo e paraqitur nga FSHU nëpërmjet korrespondencës sipërcituar. Normalisht, ky shpenzim përfshin dhe koston e disbalancave të shkaktuara nga konsumatorët e lidhur në nivelet e tensionit të cilët shërbehen nga FSHU sh.a. në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Deri në momentin që këto kosto nuk janë evidentuar, ato do të përlllogariten bashkë me kostot të cilat i përkasin aktivitetit të shërbimit universal, meqënëse kostot administrative rikuperojnë një pjesë të kostove të disbalancave të cilat nuk mund të shpërndahen drejtë te klientët e lidhur në nivelet e tensionit 35/20/10/6 kV.

ERE, rast pas rasti në procedurat e përcaktimit të çmimi të FMF, ka kërkuar prej FSHU sh.a. përcjelljen e kostove të disbalancave të klientëve të cilët shërbehen në kushtet e mundësisë së fundit, por FSHU deri më tani nuk i ka përcjellë këto kosto. Meqënëse prej 1 janarit të këtij viti klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV kanë dalë në tregun e lirë dhe kostot të cilat shkaktohen prej të gjithë klientëve FMF do të jenë të konsiderueshme, FSHU duhet të përcjellë kosto reale të disbalancave për nivel tensioni me qëllim alokimin e tyre drejtë ndaj klientëve fundorë.

Kosto e transmetimit dhe kosto e shpërndarjes

Kosto e transmetimit te energjise	3,921
Sasia e shitur e energjise	4,613
Tarife transmetimi	0.85
Kosto e shperndarjes se energjise	29,615
Sasia e shitur e energjise	4,613
Kosto e shperndarjes	6.42

Sa i takon kostos së transmetimit si dhe kostos së shpërndarjes, janë konsideruar tarifat prej 0.85 lekë/kWh për transmetimin e energjisë elektrike, si dhe 6.4 lekë/kWh për shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelin e tensionit 0.4 kV.

Kosto e transmetimit dhe kosto e shpërndarjes së energjisë së konsideruar është mbështetur në tarifat rezultuese për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, të cilat përfshijnë dhe të ardhurat e papërfituara në periudhën 1 Janar – 30 Prill të vitit 2022 të operatorëve të rrjeteve sipas arsytimit të relacioneve mbi tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes për vitin 2022.

Kosto e financimit të kapitalit të punës

Kosto e financimit te kapitalit te punes	120
Sasia e energjise per tu shitur	4,613
Kosto e financimit te kapitalit te punes	0.03

Kosto e financimit të kapitalit të punës është përlogaritur në zbatim të përcaktimeve të Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU). Kapitali i punës i përlogaritur është vlerësuar sa 1/12 e Shpenzimeve operative dhe kostos së blerjes së energjisë, kostos së transmetimit dhe kostos së shpërndarjes së energjisë elektrike sikurse shpjeguar më lartë.

Marzhi i fitimit

Fitimi	264
Sasia e shitur e energjise elektrike	4,613
Marzhi i fitimit	0.06

Marzhi i fitimit të shoqërisë është vlerësuar sipas normës së pranuar nga ERE prej 2.2% të konsideruar dhe në periudhën e mëparshme ushtrimore. Arsytet e vlerësimit të të njëjtës normë, lidhen me faktin se shoqëria të gjithë sasinë e energjisë elektrike që do të shërbejë për furnizimin e klientëve fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV do ta prokurojë tërësisht nga KESH sh.a., kundrejt çmimit 2.6 Lekë/kWh dhe shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrishtit të prokurimit të energjisë elektrike në tregun e lirë.

Për gjithë sa më sipër, kostot e përshkruara në këtë vlerësim paraqiten bashkë me përlogaritjet përkatëse sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Vlersimi i ERE 2022
OPEX	2,463
BORXHI I KEQ	2,436
Total	4,899
Sasia e enegjise se shitur	4,613
Kosto administrative dhe shpenzime te tjera (CA)	1.06
Kosto e blerjes se energjise	11,994
Sasia e enegjise se shitur	4,613
Kosto e blerjes blerjes	2.60
Amortizimi	50
Sasia e enegjise per tu shitur	4,613
Kosto e amortizimit	0.01
Kosto e disbalancave	303
Sasia e enegjise per tu shitur	4,613
Kosto e disbalancave	0.07
Kosto e financimit te kapitalit te punes	120
Sasia e enegjise per tu shitur	4,613
Kosto e financimit te kapitalit te punes	0.03
Kosto e transmetimit te energjise	3,921
Sasia e shitur e energjise	4,613
Tarife transmetimi	0.85
Kosto e shperndarjes se energjise	29,615
Sasia e shitur e energjise	4,613
Kosto e shperndarjes	6.42
Korigjimi i të ardhurave	- 2,528
Sasia e shitur e energjise elektrike	4,613
Korigjimi	- 0.55
Fitimi	264
Sasia e shitur e energjise elektrike	4,613
Marzhi i fitimit	0.06
Cmimi mesatar i shitjes se energjise	10.54

Në përfundim të këtij vlerësimi, çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike prej 10.7 lekë/kWh pritet të rekuperojë të gjitha kostot e aktivitetit të furnizimit të shërbimit universal pas transferimit të kostove të blerjes, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Nga ana tjetër duke mos patur në dispozicion të dhënat reale të shoqërisë dhe të paraqitura sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, çmimet e miratuara nga ERE duhet të vijojnë të mbeten në fuqi me qëllim vijimin e aktivitetit normal të FSHU sh.a., deri në përfundim të vitit 2022. Të ardhurat e realizuara mbi/nën ato të lejuara do të korigjohen nga ERE në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.189, datë 23.11.2017, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a. sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi

Për gjithë sa më sipër shpjeguar dhe në mbështetje të neneve 83 dhe 85 të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” i ndryshuar; VKM-s nr. 244 datë 30.03.2016,

“Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “c” të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016; dhe “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.189, datë 23.11.2017, i propozojmë Bordit të ERE-s:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021 sipas tabelës bashkëlidhur. (Tabela)

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIU DHËN 1 MAJ - 31 DHJETOR 2022		
Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)
* Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV	11	12.65
* Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV	11	12.65
* Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
* Çmimi i shitjes për Klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4	14.3
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Objekte kulturi/bashkësi fetare	9.5	
Familjarë	9.5	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambjentet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
* Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe /ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i këtyre çmimeve		
**Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është :		
- Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
- Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

2. Klientët të cilët kanë plotësuar kushtet ligjore dhe /ose teknike për daljen në tregun e liberalizuar të energjisë elektrike nuk janë subjekt i parashikimeve të pikës 1.